



A.nr.300/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.300/2026, të datës 16.03.2026, të parashtruar nga ankuesja RR.D nga Gjakova, kundër organit të punësimit/Sekretariatit i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.08.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.300/2026, e datës 16.03.2026, e parashtruar nga ankuesja RR.D, në atë mënyrë që aprovohet si i bazuar pretendimi lidhur me shqiptimin e dy masave disiplinore, ndërsa, refuzohen pretendimet tjera si në ankesë.

II. Shfuqizohet akti i datës 19.02.2026, i Kreut të Njesisë Ligjore në Gjykatën Komercial, për shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuese “vërejtje verbale dhe paralajmërim me shkrim”, ndërsa, çështja disiplinore e ankueses kthehet në rishqyrtim dhe rivendose të organi që ka nxjerrë aktin e kontestuar.

III. Obligohet Kreu i Njesisë Ligjore, të Gjykatës Komerciale, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të rishqyrtoj çështjen disiplinore të ankueses duke vepruar në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetim të vendimit.

IV. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës të përkujdesen për zbatimin e këtij vendimi siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile RR.D (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 12.03.2026, përmes postës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 16.03.2026 dhe e regjistruar nën shenjë A.nr.300/2026, kundër aktit të datës 19.02.2026 të Kreut të Njesisë Ligjore në Gjykatën Komerciale për shqiptimin e masës disiplinore “Vërejtje verbale dhe paralajmërim me shkrim”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa, ky i fundit ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorie administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 1354/2026 të datës 16.03.2026, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktin e datës 19.02.2026 të nxjerr nga Kreu i Njesisë Ligjore në Gjykatën Komerciale për shqiptimin e masës disiplinore; Emailin e datë 10.03.2026 nga Y.P për ankuesen; Emailin e datës 26.0.2026 nga ankuesja për Y.P; Zarfën e datës 12.03.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 24.03.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 08.04.2026; Akt Emërimit e datës 19.12.2025; Emailin e datës 18.02.2026 nga Y.P për K.G; Shkresën e takimit të mbajtur më datë 19.02.2026; Raportin e brendshëm-konstatimit e shkeljes disiplinore i datës 19.02.2026 nga Kreu i Njesisë Ligjore.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses, është pjesërisht e bazuar dhe çështja duhet të kthehet në rishqyrtim, sepse:

I. Gjendja e çështjes

Nga analizimi i shkresave të lëndës rezulton se:

- Ankuesja sipas Akt Emërimit më numër Referencë: 1718/2025, të datës 19.12.2025, ushtron pozitën Zyrtare Ligjor në Gjykatën Komerciale.
- Bazuar në takimin e mbajtur më datë 19.02.2026, dhe raportit të brendshëm-konstatimit të shkeljes disiplinore të datës 19.02.2026, Kreu i Njesisë Ligjore në Gjykatën Komerciale, në cilësi të mbikëqyrëses së ankues ka shqiptuar ndaj të njëjtës masën disiplinore “vërejtje verbale dhe paralajmërim me shkrim”, mbi bazën e konstatimit së ankuesja ka bërë shkelje të lehtë disiplinore sipas nenit 8.3 të Rregullores Nr.03/2024 për Procedurën Disiplinore për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton aktin e datës 19.02.2026 të Kreut të Njesisë Ligjore në Gjykatën Komercial për shqiptimin e masës disiplinore “*Vërejtje verbale dhe paralajmërim me shkrim*”, më pretendimin së janë shqiptuar dy masa disiplinore për një shkelje, në kundërshtim me nenin 61 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë. Tutje, pretendon se gjatë komunikimit më telefon më SPEAKER, me referenten S.SH, ka qenë prezent gjyqtari A.R, të njëjtës me kërkesën e gjyqtarit i ka kërkuar që të vij në zyre se bashku me fletoren që e kishte dorëzuar lëndën të marr lëndën e tillë, ndërsa referentja S.S ka kërkuar pse duhet të vij lartë pasi që është e vetme në zyre, ku gjatë bisedës dëgjoj disa zëra dhe e pyes të njëjtën me qëllim të sqarimit “*S.. me kënd je duke fol*” dhe ajo më përgjigjet “*me Rr.*”, dhe nuk e kam pyetur të njëjtën “*...a e din me kënd je duke fol*” siç ka pretenduar e njëjta, dhe për keqkuptimin që ka ndodhur i kam kërkuar falje. Me tej ankuesja shton së nuk janë respektuar procedurat e parapara me Rregulloren Nr. 03/2024 për Procedurën Disiplinore për Nëpunësit në Administratën e Sistemit Gjyqësor. Kërkon që ankesa të aprovohet, të shfuqizohet akti për shqiptimin e masave disiplinore dhe të obligohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë të ndërmarr veprimet për shlyerjen e masave disiplinore nga dosja personale.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA), me të cilin përcaktohet se: *1. Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj.*, dhe si rrjedhojë, Kolegji fillimisht konstaton së KMPSHCK-ja ka kompetencë lëndore për trajtimin e kësaj çështje juridike-administrative siç përcaktohet me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesja ka legjitimitetin e palës në procedurë dhe së ankesa konsiderohet e parashtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar më nenin 127, paragrafi 1 të LPPA-së.

Në ndërlidhje me konstatimin si me sipër, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: “*4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë*”, kështu që, nisur nga ky përcaktim ligjor të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor kanë statusin e nëpunësit civilë më status të veçantë dhe së Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si institucion i sistemit të drejtësisë ka rregulluar me akt të veçantë ligjor procedurën e disiplinës, gjegjësisht me Rregulloren Nr.03/2024 për Procedurën Disiplinore për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, e mbi këtë bazë Kolegji në trajtim të çështjes mori parasysh:

-Nenin 4 [Parimet e procedurës disiplinore] *Procedura disiplinore ndaj nëpunësit iniciohet dhe udhëhiqet në pajtim me parimin e ligjshmërisë, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, efektivitetit, efikasitetit,*

paanësisë, pavarësisë profesionale, transparencës, trajtimit të barabartë për komunitete dhe gjini, parimin e barabarësisë së armëve, prezumimit të pafajësisë dhe individualizimit të masës disiplinore siç janë të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe në ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

- Nenin 7 [Përgjegjësia disiplinore] 1. Nëpunësi mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim. 2. Përgjegjësia penale apo lirimi nga përgjegjësia penale nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore, nëse në veprimet e nëpunësit vlerësohet se janë konsumuar shkelje disiplinore.

-Nenin 8 [Shkeljet disiplinore] 1. Shkeljet disiplinore nënkuptojnë shkeljen e detyrave dhe përgjegjësi të punës dhe ndahen në: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 2. Shkeljet e lehta të detyrave dhe përgjegjësi të punës janë: 2.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 2.2. mosrespektimi i orarit të punës; 2.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun. 3. Shkelje të rënda të detyrave dhe përgjegjësi të punës janë: 3.1. mospërbushja e detyrave të punës; 3.2. neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 3.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 3.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 3.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 3.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e sistemit gjyqësor; 3.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 3.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 3.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 3.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 3.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësi; 3.13. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 3.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 3.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja i dehur në punë; 3.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët e komisionit disiplinor dhe zyrtarët e NjMBNj; 3.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 3.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës kundër Diskriminimit; 3.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe këtë rregullore.

-Nenin 9 [Masat disiplinore] 1. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunësit, për shkelje të lehta janë: 1.1. vërejtje verbale; 1.2. paralajmërim me shkrim; 1.3. vërejtje me shkrim. 2. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunësit, për shkelje të rënda janë: 2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë për qind (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 2.4. ulja në pozitë; 2.5. pezullimi nga

pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 2.7. largimi nga administrata e sistemit gjyqësor.

-Nenin 10 [Kompetenca për shqiptimin e masave disiplinore] 1. Organ kompetent për shqiptimin e masave disiplinore janë: 1.1. mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit; 1.2. Komisioni Disiplinor. 2. Masa disiplinore për shkelje të lehta shqiptohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit. 3. Masat disiplinore për shkelje të rënda shqiptohen nga Komisioni Disiplinor.

Kolegji i Këshilli në kuptim të kuadrit ligjor si më sipër analizoj aktin e kontestuar edhe në ndërlidhje me provat materiale dhe si rrjedhojë konstatoi se akti i goditur me ankesë është përfshirë në shkelje materiale sepse, ndaj ankueses për një shkelje disiplinore i janë shqiptuar dy masa disiplinore, veprim ky në kundërshtim me nenin 61, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat Publike, ndërlidhur me nenin 2 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 03/2024 për Procedurën Disiplinore për Nëpunësit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, andaj, mbi këtë konstatim rezulton se është i bazuar pretendimi mbi këtë bazë.

Ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankueses se nuk ka bërë shkelje disiplinore të supozuar, Kolegji i Këshillit ka gjetur se mbikëqyrësja e ankueses shqiptimin e masave disiplinore sipas aktit të kontestuar e ka mbështet si rezultat i të gjeturave nga takimi i datës 19.02.2026, i mbajtur në zyrën e Administratorit të gjykatës ku pjesëmarrës ishin: RR.D, S.SH-Referente (shkalla I), B.B-Referente (shkalla I), B.B-V-Referente (shkalla II), K.G-Administrator, Y.P-A-Kreu i Njësisë Ligjore dhe A.Z-Udhëheqës e ZML-së, ashtu që nga ky takim mbikëqyrësja e ankuesit kishte përgatit dokumentin me titull “minutat e takimit” dhe dokumentin më titull “Raporti i Brendshme”. Gjegjësisht, nga vlerësimi i këtyre dokumente rrjedhë se ankuesja më datë 18.02.2026, gjatë një bisede telefonike me referentën S.SH kishte pas komunikim të pahijshëm duke cituar tekstin “*S. a e din me kond je tu fol*”, bisedë kjo që ishte dëgjuar nga Udhëheqësja e ZML-së, ku e njëjta edhe e kishte raportuar këtë komunikim të ankueses. Po ashtu, në dokumentet në fjalë, është evidentuar fakti që përveç referentes S.SH, herë pas herë ankuesja ka pas komunikim të ngjashëm edhe me referente tjera si B.B dhe B.B, të cilat sipas thënies në shkresat respektive kanë shprehur shqetësime lidhur me qasjen e ankueses në raport me to.

Rrjedhimisht, meqenëse dokumenti me titull “minuat e takimit” i datës 19.02.2026, i përgatitur vetëm nga Kreu i Zyrës Ligjore, ka fuqinë e një procesverbali, e duke qenë se ky dokument përmban deklarata të zyrtarëve prezent në takimin e datës 19.02.2026, atëherë, në vlerësimin e Kolegjit ky dokument duhej të nënshkruhej nga të gjitha palët pjesëmarrëse të takimit, sepse, vetëm përmes nënshkrimit mund saktësohet vërtetësia e konstatimeve të thëna në shkesën “Minutat e Takimit”, andaj, Kolegji vetëm mbi bazën e këtij dokumenti nuk mund të konstatojë nëse në veprimet e ankueses manifestohet elementet e shkeljes së lehtë disiplinore“ sjellje e pahijshme më koleget”.

Për më tepër, për Kolegjin teksti i komunikimit të ankueses me referentën S.SH ashtu siç përshkruhet në aktin e kontestuar, nuk tingëllon si gjuhë apo komunikim i pahijshëm i ankueses, mirëpo, mënyra dhe tonaliteti i përdoruar janë fakte relevante për konstatime të një shkelje të tillë, e që mbi gjendjen faktike të disponueshme në procedurë ankimore, këto fakte nuk mund të vërtetohen, kështu, që marrë parasysh edhe konstatimin për sjellje të ngjashme të ankueses të përsëritura edhe me zyrtarë tjerë, atëherë, në vlerësimin e Kolegjit ankueses duhet t’i tërhiqet vëmendje me gojë që veprimet komunikuese të ankueses më stafin e

punës duhet të përmirësohen, në të kundërtën përsëritja e sjelljeve të ngjashme përbën bazë për masa më të rënda disiplinore.

Andaj, nisur nga gjetjet dhe vlerësimet si më lart, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundim së për shkak të të metave të konstatuar, vendosja meritorë lidhur me këtë çështje disiplinore nuk është e mundur, kështu që, më qëllim të kthimit të ligjshmërisë e duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht, aprovoj pjesërisht ankesën si të bazuar, shfuqizoj aktin e datës 19.02.2026 të Kreut të Njesisë Ligjore në Gjykatën Komercial për shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuese “vërejtje verbale dhe paralajmërim me shkrim”, ndërsa, çështja disiplinore e ankueses kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi që ka nxjerrë aktin e kontestuar, me detyrimin që mbikëqyrësja e ankues në ri procedurë të shqyrtoja çështjen disiplinore të ankueses duke vepruar në pajtim me konstatimet dhe pikëpamjet juridike si në arsyetim të këtij vendim.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.300/2026

Avdyl BEKTESHI

Procembajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses RR.D;
- Organit të punësimit: Drejtorit të Përgjithshëm, Kreut të Njesisë Ligjore, të Gjykatës Komerciale dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në SKGJK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së